

KOMPANIA RAJONALE E UJËSJELLËSIT
SH. A.



KOMPANIA E UJËSJELLËSIT RAJONAL
R K VODASNABEDVANJE
HIDRODRINI
SH. A. PEJE D.D. - PEC
Nr.-Br. 419 Dat. 12.06.2017

Zyret qendrore

Rr. Lekë Dukagjini Nr. 156

30000 Pejë Telefoni: 039 / 432 355

www.hidrodrini.com

REPUBLICA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
Autoreti Regulator për Shërbimet e Ujit
Regulatori Autoriteti za Usluge Vode
Water Services Regulatory Authority

Nr. emisioni / Broj Prot. No. 362/02
Niveli i Shtetit / Ust. D
Nr. emisioni / Broj Prot. No. 13/06/2017
Data / Datum / Date
PRISHTINE - PRISTINA - PRISTINA

RREGULLORE NR 02/2017

PËR PROCEDURAT E LIDHJES SË KONSUMATORËVE NË
SHËRBIMET E UJIT

Maj, 2017

Në mbështetje të Nenit 48 paragrafi 2 lidhur me nënparagrafin 2.6.2 të Ligjit Nr. 05/L - 042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, dhe të nenit ___, paragrafi __ të Statutit të Kompanisë, Bordi i Drejtorëve të KRU "Hidrodrini" Sh. A Pejë, nxjerr këtë:

Rregullore Nr 02/2017 për Procedurat e Lidhjes së Konsumatorëve në Shërbimet e Ujit

KREU I

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Fushëveprimi dhe Qëllimi

1. Me këtë Rregullore përcaktohen rregullat e KRU "Hidrodrini" Sh. A. Pejë, për lidhjen dhe ri-lidhjen e konsumatorëve në shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit. Kjo rregullore përcakton procedurat e detajuara që duhet të ndiqen nga personeli i Kompanisë, për lidhjen e konsumatorëve të rinj në rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit.

2. Miratimi i kësaj Rregullorje ka qëllim të dyfishtë:

2.1 Të vendos një kornizë mbi të cilën Kompania planifikon dhe zbaton lidhjen e konsumatorëve të rinj në shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, si dhe

2.2 Të definojë veprimet specifike që duhet të ndiqen nga personeli i kompanisë me rastin e procedimit të aplikacioneve për lidhje dhe ndërtimin e lidhjeve të reja në sistemin e ujësjellësit dhe kanalizimit, apo legalizimin e lidhjeve ekzistuese.

Neni 2

Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë kuptimin si vijon:

1.1 **"Ankesë"** është çdo kundërshtim apo raportim në çfarëdo forme të pakënaqësisë së konsumatorit me cilindo aspekt të shërbimeve që ofron ofruesi i shërbimeve;

1.2 **"Kërkesë"** është çdo kërkesë e bërë me gojë ose me shkrim nga konsumatori në lidhje me cilindo aspekt të shërbimeve që ofron ofruesi i shërbimeve;

1.3 **"ARRU"** është Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit;

1.4 **"KRU"** është Kompania Rajonale e Ujësjellësit;

1.5 **"DSHK"** është Departamenti i Shërbimit të Konsumatorëve;

1.6 **"Kompani"** – ka kuptimin e njëjtë si të KRU-së;

1.7 **"Konsumator"** - personi i cili ka lidhur kontratë për shërbime me ofruesin e shërbimeve dhe/ ose merr shërbime nga Ofruesi i shërbimeve;

1.8. **Lidhja e autorizuar** – lidhja në mes të objekteve të konsumatorit dhe rrjetit shpërndarës të shërbimeve të ujësjellësit dhe ujërave të ndotura, të ofruara nga ofruesi i shërbimeve sipas ligjit;

1.9. **Lidhja e pa autorizuar** – lidhja në mes të objekteve të konsumatorit dhe rrjetit shpërndarës për shërbimet e ujësjellësit dhe ujërave të ndotura që nuk është kryer nga ofruesi i shërbimeve të ujësjellësit dhe ujërave të ndotura në pajtim me ligjin.

Neni 3 Zbatueshmëria

1. Kjo rregullore është dokument zyrtar dhe si e tillë ajo është e zbatueshme nga i gjithë personeli i kompanisë që është i përfshirë në procedimin dhe implementimin e lidhjeve të reja. Po ashtu, kjo rregullore është me interes edhe për konsumatorët, si dhe palët tjera të interesit.

2. Mosrespektimi i kësaj rregulloreje paraqet shkelje të rregullave të punës dhe rrjedhimisht sanksionohet me masa ndëshkimore konform procedurës disiplinore të kompanisë.

3. Për interpretimin e rregullave dhe procedurave të përcaktuara me këtë rregullore, si dhe për zgjidhjen e keqkuptimeve eventuale apo rasteve të veçanta, duhet të kontaktohet zyra Ligjore e kompanisë.

Neni 4 Baza ligjore

1. Korniza ligjore për lidhjen e konsumatorëve të rinj në shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit është përcaktuar me:

1.1 Ligjin Nr. 05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në janar 2016.

1.2 Ligjin Nr. 04/L-121 për Mbrojtjen e Konsumatorit, i dekretuar nga Presidenti i Republikës me 07. 11. 2012

1.3 Rregulloret e miratuara nga ARRU në bazë të Ligjit,

1.3.1 Rregullorja Nr. 02/2016 për Standardet Minimale për Shërbimet e Ujit,

1.3.2 Rregullorja Nr. 03/2016 për Kartën e Konsumatorëve.

Neni 5 Parimet e kompanisë për lidhjen e konsumatorëve në shërbime

1. Parimet bazë për lidhjen e konsumatorëve të rinj në shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit janë të bazuara në Ligj dhe njëkohësisht demonstrojnë përkushtimin e kompanisë për:

- 1.1 Ngritjen e shkallës së mbulueshmërisë me shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit;
- 1.2 Ofrimin e shërbimeve për të gjithë popullatën në zonën e vet të shërbimit, kurdo që është teknikisht dhe financiarisht e realizueshme;
- 1.3 Trajtimin e drejtë dhe të barabartë të të gjithë konsumatorëve;
- 1.4 Pengimin e lidhjeve ilegale dhe dukurive tjera abuzive në sistemin e ujësjellësit dhe kanalizimit;
- 1.5 Mbrojtjen e shëndetit publik dhe të infrastrukturës së ujësjellësit.

KREU II

PROCEDURAT PËR LIDHJEN E KONSUMATORËVE

Neni 6 Kushtet për lidhje

1. Lidhja në shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit mund të realizohet vetëm sipas kushteve të përcaktuara nga kompania.
 - 1.1 Kompania i përcakton kushtet për lidhje në bazë të procedurave dhe projektit të aprovuar të instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit.
2. Aplikuesi për lidhje është i obliguar që të sigurojë:
 - 2.1. të gjitha pëlqimet dhe lejet e nevojshme nga organet kompetente;
 - 2.2. të kryejë të gjitha punimet e nevojshme tokësore në bazë të udhëzimeve të kompanisë;
 - 2.3 është përgjegjës për të gjitha dëmet që mund të shkaktohet me rastin e kryerjes së punimeve tokësore;
 - 2.4 është i obliguar që të paguajë të gjitha shpenzimet e lidhjes;
 - 2.5 që të përgatisë vendin (pusetën) ku do të vendoset ujëmatësi. Puseta e ujëmatësit duhet të ketë formën dhe dimensionet e përcaktuara nga kompania;
 - 2.6 Kompania përcakton pikën e lidhjes në rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit, si dhe diametrin dhe materialet që do të përdoren për punimin e lidhjes.
3. Kompania i kalkulon dhe faturon shpenzimet e lidhjes në bazë të tarifave në fuqi të aprovuara nga ARRU. Pas kryerjes së punimeve kompania e bënë llogarinë përfundimtare – faturën për punët e përfunduara.

Neni 7

Punimi i lidhjes

1. Lidhja në shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit kryhet nga kompania. Lidhja mund të kryhet edhe nga kontraktori i pavarur me kusht që një gjë e tillë të bëhet nën mbikëqyrjen dhe pranimin teknik të kompanisë.
2. Lidhjet të cilat janë kryer pa autorizimin e kompanisë, do të konsiderohen si lidhje të paautorizuara (ilegale) dhe do të ndërpriten.
3. Në raste të veçanta kompania mund të vendosi që t'i legalizojë këto lidhje me kërkesën e pronarit të lidhjes me kusht që:
 - 3.1. lidhja të jetë e punuar sipas normave dhe standardeve të pranueshme për Kompaninë, si dhe,
 - 3.2. të paguhen të gjitha obligimet ndaj kompanisë të faturuara në pajtim me legjislacionin në fuqi.
4. Punimet tokësore parimisht nuk kryhen nga kompania. Me kërkesën specifike të aplikuesit për lidhje, kompania mund t'i kryejë edhe punët tokësore dhe në këtë rast aplikuesi për lidhje i bart shpenzimet në bazë të çmimeve të Kompanisë për këto lloje të punimeve.

Neni 8

Shpenzimet e punimit të lidhjes

Aplikuesi për lidhje është përgjegjës për mbulimin e të gjitha shpenzimeve që shkaktohen në lidhje me realizimin e lidhjes. Ai është përgjegjës edhe për mbulimin e shpenzimeve që lidhen me nxjerrjen e pëlqimeve dhe lejeve të nevojshme.

Neni 9

Instalimi i ujëmatësit

1. Të gjitha lidhjet e reja në shërbimet e ujësjellësit duhet të kenë të instaluar ujëmatësin e tipit, diametrin, dhe kapacitetin matës ashtu siç e përcakton kompania. Lokacioni për vendosjen e ujëmatësit, si dhe dimensionet e vendstrehimit të ujëmatësit përcaktohen nga kompania. Një rregull e tillë vlen edhe për lidhjet e përkohshme të cilat shfrytëzohen gjatë fazës së ndërtimit të objektit/ve.
2. Aplikuesi për lidhje/konsumatori është përgjegjës për mbulimin e të gjitha shpenzimeve që lidhen me blerjen dhe instalimin e ujëmatësit.
3. Konsumatori është përgjegjës që të sigurojë ujëmatësin dhe vulën (pllomben) prej dëmtimeve fizike. Rreptësisht ndalohet që konsumatori apo personat tjerë të pa-autorizuar të manipulojnë me ujëmatësin në çfarëdo forme. Një veprim i tillë i nënshtrohet masave ndëshkimore sipas legjislacionit të zbatueshëm.

4. Kompania i bart shpenzimet e mirëmbajtjes së rregullt dhe zëvendësimit të ujëmatësit, nëse ajo ka mëdyshje për funksionalitetin e tij. Mirëpo, në rast se ujëmatësi dëmtohet qëllimisht nga konsumatori apo si pasojë e neglizhencës së tij dhe moskujdesit të tij, atëherë konsumatori i bart shpenzimet e riparimit apo zëvendësimit të tij.

Neni 10 **Dëmet në sistemin e kanalizimit**

Kompania nuk mban përgjegjësi në rast të dëmeve që mund ti shkaktohen konsumatorit nga përmbytja me ujëra të zeza nga sistemi i kanalizimit, në rast se këto dëme kanë ndodhur si pasojë e mos-instalimit apo mosfunksionimit të pajisjeve mbrojtëse (valvuleve jo-kthyese).

KREU III **PROCEDURA E LIDHJES NË SHËRBIM**

Neni 11 **Dorëzimi i aplikacionit për lidhje**

1. Aplikuesi për lidhje në shërbimet e ujësjellësit apo kanalizimit e plotëson dhe e dorëzon aplikacionin standard për lidhje tek zyrtari përgjegjës.
2. Për tu konsideruar i kompletuar aplikacionit duhet ti bashkëngjitet dokumentacioni i nevojshëm që është i specifikuar në formularin e aplikacionit përkatës.

Neni 12 **Procedimi i aplikacionit për lidhje**

1. Zyrtari përgjegjës e protokollon aplikacionin dhe në ditën e njëjtë e përcjellë tek zyrtari për marrëdhënie me konsumator.
 - 1.1. Zyrtari përgjegjës aplikacionin e kompletuar për lidhje individuale ose kolektive, e dorëzon tek personi i autorizuar nga kompania për realizimin e lidhjes, më së voni në ditën e ardhshme të punës.
 - 1.2. Personi i autorizuar nga kompania për ekzekutimin e lidhjes, në afat prej tri (3) ditëve të punës e njofton zyrtarin për marrëdhënie me konsumator për datën e daljes në vend të ngjarjes, për të përcaktuar detajet teknike të lidhjes.
 - 1.2.1 Data e daljes në vendin e ngjarjes nuk duhet të jetë më vonë se pesë (5) ditë pune nga data e dorëzimit të aplikacionit të kompletuar.
 - 1.3. Personi i autorizuar nga kompania pas shikimit të vendit të ngjarjes në afat prej dy (2) ditëve pune, përgatitet vendimin për aprovim ose refuzim të lidhjes, të cilin bashkë me skicat dhe përshkrimet e nevojshme teknike i dorëzon tek zyrtari përgjegjës.

2. Zyrtari përgjegjës në afat prej dy (2) ditëve pune e njofton aplikuesin për vendimin mbi aprovimin ose jo të kërkesës së tij për lidhje në rrjetin e shërbimeve të ujit, duke e njoftuar me:

- 2.1 kushtet e kompanisë lidhur me aplikacionin e tij,
- 2.2 veprimet e ardhshme që duhet të ndërmerret për aprovim/ose mos aprovim të lidhjes,
- 2.3 kryerjen e pagesës për shpenzimet e lidhjes,
- 2.4 nxjerrjen e lejes nga autoritetet komunale për lejjimin e gërmimit nëse ka nevojë.

3. Procedimi i aplikacionit dhe marrja e vendimit për aprovimin ose jo të aplikacionit duhet të kryhet në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike prej datës së dorëzimit të aplikacionit të kompletuar.

4. Zyrtari nga shërbimi financiar në bazë të kushteve dhe tarifave të shërbimit të aprovuar nga ARRU-ja përpilon faturën me shpenzimet e lidhjes dhe taksën e lidhjes që duhet të paguhet nga aplikuesi.

Neni 13 **Ekzekutimi i lidhjes**

1. Pas nxjerrjes së lejeve të nevojshme nga autoritetet komunale, aplikuesi duhet ta dorëzojë një kopje në DSHK – tek zyrtari për marrëdhënie me konsumatorë, i cili e kompletton lëndën e aplikacionit.

2. Pas nënshkrimit të kontratës së shërbimit nga ana e aplikuesit, zyrtari përgjegjës i kompanisë e kompletton dosjen e aplikuesit dhe në ditën e njëjtë e dorëzon një kopje të shërbimit për planifikim dhe zhvillim, i cili shërbim në bashkëpunim me udhëheqësin e operativës caktojnë datën e ekzekutimit të lidhjes.

2.1. Shërbimi për planifikim dhe zhvillim kërkon prej aplikuesit që të kryejë të gjitha përgatitjet e duhura (gërmimi i kanalit, sigurimi i rërës, përgatitja e pusëtës së ujëmatësit etj.).

2.2. Udhëheqësi i operativës në datën e caktuar për ekzekutimin e lidhjes, përgatitë urdhëresën e punës për ekzekutimin e lidhjes së re dhe cakton ekipin për ekzekutimin e lidhjes, bashkë me kërkesën për material i cili duhet të merret në depon e kompanisë, ose materialin adekuat që mund të sigurohet nga pala.

2.3. Ekipi për ekzekutimin e lidhjes merr materialin e nevojshëm nga depoja e kompanisë dhe pasi të ketë konstatuar se ekzistojnë kushtet, do ta ekzekutojë lidhjen sipas normave teknike të kompanisë.

3. Pas ekzekutimit të lidhjes, kryepunëtori i ekipit të operativës konstaton në urdhëresën e punës se lidhja është kryer dhe shënon detajet e nevojshme për lidhjen e ekzekutuar (materiali harxhuar, diametri i gypit, profili, tipi dhe numri serik i ujëmatësit etj.). Këto informacione i dorëzon tek udhëheqësi i operativës.

3.1. Udhëheqësi i operativës ia përcjellë një kopje të urdhëresës së punës udhëheqësit të shërbimit për planifikim dhe zhvillim me informacionet e lidhjes së ekzekutuar dhe ky i fundit e bën incizimin gjeodezik të lidhjes dhe të njëjtat i bartë në hartat e rrjetit të kësaj lidhje.

4. E tërë procedura për lidhjen e aplikuesit në rrjetin e ujësjellësit apo kanalizimit duhet të kryhet brenda pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike.

Neni 14 **Regjistrimi i konsumatorit**

Pas marrjes së informacionit se lidhja është ekzekutuar, zyrtari përgjegjës i regjistron të dhënat për konsumatorin në formularin standard të kompanisë dhe një kopje të këtij formulari e dërgon tek departamenti i shërbimit me konsumatorë, për tu regjistruar në regjistrin e faturimit.

KREU IV

LEGALIZIMI I LIDHJEVE TË PA AUTORIZUARA

Neni 15 **Dorëzimi i aplikacionit për legalizimin e lidhjes së pa autorizuar**

Pronari i objektit (apo përfaqësuesi i tij) të cilit i është konstatuar lidhja e pa autorizuar nga kompania, në rast se i është dhënë mundësia e legalizimit të lidhjes nga ana e kompanisë, e plotëson aplikacionin standard për legalizimin e lidhjes dhe e dorëzon tek zyrtari për ankesa dhe kërkesa që është përgjegjës për pranimin e aplikacioneve.

Neni 16 **Procedimi i aplikacionit për legalizimin e lidhjes së pa autorizuar**

1. Zyrtari për ankesa dhe kërkesa e regjistron aplikacionin e kompletuar dhe në ditën e njëjtë e përcjellë tek zyrtari për marrëdhënie me konsumatorë.

1.1. Zyrtari për marrëdhënie me konsumator, aplikacionin e kompletuar në ditën e ardhshme e dorëzon tek menaxheri i njësisë i cili pas shqyrtimit preliminar e përcjell tek zyrtari përgjegjës.

1.2. Shërbimi për planifikim dhe zhvillim e shqyrton aplikacionin dhe në afat prej tri (3) ditëve të punës, e njofton shërbimin e operativës për datën e daljes në vend të ngjarjes, për të verifikuar nëse lidhja ekzistuese e paautorizuar i plotëson kushtet teknike ose jo për tu legalizuar.

2. Në afat prej dy (2) ditëve të punës prej datës së shqyrtimi në vendin e ngjarjes, zyrtari përgjegjës e përgatitë dhe e dorëzon në DSHK tek zyrtari për marrëdhënie me konsumator vendimin i cili konstaton se:

- 2.1. lidhja e paligjshme i plotëson kushtet për tu legalizuar, ose
- 2.2. lidhja nuk i plotëson kushtet për tu legalizuar dhe duhet të ripunohet.

3. Zyrtari për shërbime të konsumatorëve në ditën e njëjtë e njofton aplikuesin për vendimin e kompanisë lidhur me aplikacionin e tij për legalizimin e lidhjes dhe e njofton për veprimet e ardhshme që duhet ti ndërmerr ai.

4. Procedimi i aplikacionit dhe marrja e vendimit për aprovimin ose jo të aplikacionit, duhet të bëhet në afat prej dhjetë (10) ditëve kalendarike prej datës së dorëzimit të aplikacionit.

Neni 17

Legalizimi i lidhjes së pa autorizuar

1. Në rastin kur vendimi i kompanisë është pozitiv dhe konstatohet se lidhja ilegale i plotëson kushtet për tu legalizuar, shërbimi financiar e përpilon faturën me shpenzimet e lidhjes dhe taksën e lidhjes që duhet të paguhet nga aplikuesi në pajtim me tarifat e aprovuara nga ARRU-ja.

2. Pas nënshkrimit të kontratës së shërbimit dhe akordimin e kushteve të pagesës nga aplikuesi, zyrtari përgjegjës plotëson lëndën e aplikuesit në ditën e njëjtë dhe e dorëzon një kopje tek shërbimi për planifikim dhe zhvillim.

3. Pas marrjes së dosjes për pagesën e kryer nga ana e aplikuesit, udhëheqësi për planifikim dhe zhvillim i regjistron të dhënat për konsumatorin në formularin standard të kompanisë dhe një kopje të këtij formulari e dërgon tek zyrtari përgjegjës për tu regjistruar në regjistrin e faturimit.

Neni 18

Ndërprerja e procedurës për legalizimin e lidhjes së pa autorizuar

Në rast se shërbimi për planifikim dhe zhvillim ka konstatuar se lidhja e pa autorizuar nuk i plotëson kushtet për tu legalizuar, do të përcjellë dosjen tek zyrtari përgjegjës për zbatimin e procedurave për ndërprerje, në pajtim me Ligjin Nr. 05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit.

KREU V

RI-LIDHJA NË SHËRBIMET E UJËSJELLËSIT

Neni 19

Ri-lidhjet pas ndërprerjes së shërbimeve

1. Asnjë person tjetër, përveç ofruesit të shërbimeve i cili ka bërë ndërprerje të një konsumatori nga shërbimet e ujësjellësit, nuk ka të drejtë të bëjë ri-lidhjen e atij konsumatori në shërbimet e ujësjellësit.

2. Rastet e ndërprera nga shërbimet e ujësjellësit do të ri-lidhen në shërbime pas eliminimit të shkaqeve për ndërprerje.

2.1. Konsumatori me dëshmi për eliminimin e shkaqeve të ndërprerjes së shërbimeve i drejtohet me aplikacion zyrtarit përgjegjës i cili protokollon të njëjtën dhe në ditën e njëjtë e procedon në shërbim përkatës për verifikim.

2.2. Shërbimi përgjegjës pas vërtetimit me shkrim se janë eliminuar shkaqet për ndërprerje inicion procedurat për ri-lidhje, duke proceduar aplikacionin te zyrtari përgjegjës, i cili jep urdhëresë për ekzekutimin e lidhjes.

2.3. Personi përgjegjës do të veprojë brenda njëzet e katër (24) orëve sipas urdhëresës për ri-lidhje. Personi përgjegjës për lidhje do të procedojë një kopje të urdhëresës më së largu në ditën e ardhshme të punës.

KREU VI

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 20

Dispozitat shfuqizuese

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohen të gjitha rregulloret, rregullat dhe vendimet që kanë të bëjnë me procedurat për lidhjen dhe ri-lidhjen e konsumatorëve në shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit.


Neni 21

Hyrja në Fuqi

Kjo rregullore hynë në fuqi pesumbdhjetë (15) ditë kalendarike pas e aprovimit nga Autoriteti Rregullator për Shërbime të Ujit, si dhe publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen zyrtare të KRU "Hidrodrini" Sh. A. Pejë.

Datë ____/____/2017
Pejë

Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve
z.Burim Basha (ing. I dipl.)



Shtojca 1: Formulari i Aplikacionit për Lidhje

[Plotësohet nga KRU "Hidrodrini" Sh. A.]

Datë: [redacted]

Nr. i Protokollit: [redacted]

[Plotësohet nga Aplikuesi]

Të dhënat për Aplikuesin:

a) Konsumatorët Shtëpiak:

Emri dhe Mbiemri: [redacted] Nr. Pers.. [redacted]

Nr. i Telefonit: [redacted]; E-mail Adresa: [redacted]

Adresa [redacted]

b) Konsumatorët Komercial/Industrial dhe Institucional:

Emërtimi: [redacted]

Nr. i Regjistrimit të Biznesit: [redacted]; Nr. i TVSH: [redacted]

Nr. i Telefonit: [redacted]; E-mail Adresa: [redacted]

Adresa: [redacted]

Të dhënat për Objektivin që do të Lidhet:

Adresa: [redacted]

Komuna: [redacted]

Kopja e Planit dhe Fleta Poseduese e bashkangjitur – Nr. [redacted]

Nënshkrimi i Aplikuesit:

[redacted]

Datë:

[redacted]

Shtojca 2: Formulari i Aplikacionit për Legalizimin e Lidhjes se pa autorizuar

[Plotësohet nga KRU "Hidrodrini" Sh. A

Datë: _____

Nr. i Protokollit: _____

[Plotësohet nga Aplikuesi]

Të dhënat për Aplikuesin:

a) Konsumatorët Shtëpiak:

Emri dhe Mbiemri: _____ Nr. personal: _____

Nr. i Telefonit: _____; E-mail Adresa: _____

Adresa: _____

b) Konsumatorët Komercial/Industrial dhe Institucional:

Emërtimi: _____

Nr. i Regjistrimit të Biznesit: _____; Nr. i TVSH: _____

Nr. i Telefonit: _____; E-mail Adresa: _____

Adresa: _____

Të dhënat për Objektin që do të Legalizohet:

Adresa: _____

Komuna: _____

Kopja e Planit e bashkangjitur - Nr. _____

Data e lidhjes: _____

Lloji i Ujëmatësit: _____; Nr. Serik: _____; Gjendja: _____

Nënshkrimi i Aplikuesit:

Datë:

Shtojca 3: Formulari i kushteve teknike për ekzekutimin e lidhjes

Lloji i objektit: _____

Adresa: _____

1. Lidhja në Shërbime:

Lidhja në shërbimet e ujit duhet të bëhet sipas kushteve teknike të dhëna bashkangjitur me këtë vendim.

2. Kushtet për Lidhje:

Para se të ekzekutohet lidhja, Aplikuesi është i obliguar që të:

- (i) Nxjerrë Lejen nga autoritetet komunale për gërmim në sipërfaqe publike;
- (ii) Paguajë shpenzimet e lidhjes në lartësi: _____ EUR;
- (iii) Nënshkruajë kontratën e shërbimit me KRU "Hidrodrini" Sh. A.
- (iv) Kryejë punët tokësore sipas skicës së bashkangjitur;
- (v) Ndërtojë vendstrehimin e ujëmatësit sipas skicës së bashkangjitur.

3. Ekzekutimi i Lidhjes

Pës përmbushjes së kushteve të mësipërme, ekzekutimi i lidhjes kryhet nga KRU "Hidrodrini" Sh. A

I. KUSHTET TEKNIKE PËR EKZEKUTIMIN E LIDHJES:

- Diametri i rrjetit distributiv ku duhet të bëhet lidhja: _____ mm
- Diametri i gypit të lidhjes: _____ mm
- Kapaciteti i ujëmatësit: _____ m³/orë

II. SPECIFIKACIONI I MATERIALIT:

Nr.	Përshkrimi i Materialit	DN	Njësia	Sasia	Vërejtje
1	Qafore/Amborshelne				
2	Gyp				
3	Valvula				
4	Fiting				
5	Ujëmatësi				

Shtojca 4: Forma e Vendimit për Aprovimin e Lidhjes

KOMPANIA RAJONALE E UJËSJELLËSIT
Sh. A.



Datë: _____

Nr. i Protokollit: _____

Zyret qendrore

Rr. Lekë Dukagjini Nr. 156

30000 Pejë Telefoni: 039 / 432 355

www.hidrodrini.com

Në mbështetje të nenit _____ të Rregullores nr. 02/2016 për Standardet Minimale të Shërbimit të Ujit në Kosovë dhe të nenit _____ të Rregullores 02/2017 për Procedurat e Lidhjes së Konsumatorëve në Shërbime të Ujit, pas shqyrtimit të aplikacionit Nr. _____ të datës: _____, Departamenti i Planifikimit i KRU "Hidrodrini" Sh. A. merr këtë:

VENDIM

1. Aprovohet kërkesa e z. _____ me nr. _____ datë _____ për ekzekutimin/legalizimin e lidhjes në rrjetin e ujësjellësit/kanalizimit.
2. Obligohet Departamenti _____ që të bëjë ekzekutimin/legalizimin e lidhjes në rrjetin e ujësjellësit/kanalizimit të objektit _____ në pajtim me legjislacionin në fuqi.
3. Z. _____ është i obliguar që ti kryej të gjitha obligimet të cilat i takojnë për tu realizuar ekzekutimin/legalizimin e lidhjes.
4. 2. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nxjerrjes.

Arsyetimi

Pas shqyrtimit të lëndës dhe informacioneve të hollësishme nga departamentet përkatës është konstatuar se, z. _____ i ka plotësuar të gjitha kushtet e kërkuar nga KRU "Hidrodrini" Sh. A. për ekzekutimin/legalizimin e lidhjes në rrjetin e ujësjellësit/kanalizimit, dhe i është aprovuar ekzekutimi i lidhjes i cili duhet ti kryhet nga KRU "Hidrodrini" Sh. A. sipas afateve të cekura në Rregulloren 02/2017 për Procedurat e Lidhjes së Konsumatorëve në Shërbime të Ujit.

Nga arsyet e cekura më lartë udhëheqësi i dep. _____ ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilla juridike; Pala e pakënaqur me këtë vendim ka të drejtë ankese te Komisioni për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave pranë kompanisë në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike nga data e pranimit të këtij vendimi.

Dërguar;
1x Konsumatorit,
1x Arkivivit
1x Dep.....

Udhëheqësi i Dep....

Shtojca 5: Forma e Vendimit për Refuzimin e Lidhjes

KOMPANIA RAJONALE E UJËSJELLËSIT
SH. A.



Datë: _____

Nr. i Protokollit: _____

Zyret qendrore

Rr. Lekë Dukagjini Nr. 156

30000 Pejë Telefoni 039 / 432 355

www.hidrodrini.com

Në mbështetje të nenit ___ të Rregullores nr. 02/2016 për Standardet Minimale të Shërbimit të Ujit në Kosovë dhe të nenit ___ të Rregullores 02/2017 për Procedurat e Lidhjes së Konsumatorëve në Shërbime të Ujit, pas shqyrtimit të aplikacionit Nr. _____ të datës: _____, Departamenti i Planifikimit i KRU "Hidrodrini" Sh. A. merr këtë:

VENDIM

1. Refuzohet kërkesa e z. _____ me nr. _____ datë _____ për ekzekutimin/legalizimin e lidhjes në rrjetin e ujësjellësit/kanalizimit si e pa kompletuar....
2. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nxjerrjes.

Arsyetimi

Pas shqyrtimit të lëndë dhe informacioneve të hollësishme nga departamentet përkatës Dep. për Lidhje konstatoi se, z. _____ nuk i ka plotësuar të gjitha kushtet e kërkuar nga KRU "Hidrodrini" Sh. A. për ekzekutimin/legalizimin e lidhjes në rrjetin e ujësjellësit/kanalizimit për; _____, në pajtim me Rregulloren 02/2017 për Procedurat e Lidhjes së Konsumatorëve në Shërbime të Ujit. Kërkuesit i mungojnë; _____

Nga arsyet e cekura më lartë udhëheqësi i dep. _____ ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilla juridike; Pala e pakënaqur me këtë vendim ka të drejtë ankese te Komisioni për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave pranë kompanisë në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike nga data e pranimit të këtij vendimi.

Dërguar;
1x Konsumatorit,
1x Arkivivit
1x Dep....

Udhëheqësi i Dep....

Shtojca 6: Forma e Regjistrimit të Konsumatorit të Ri

Datë: _____

Nr: _____

Emri dhe Mbiemri: _____

Nr. i Telefonit: _____ ; E-mail adresa: _____

Adresa: _____

Komuna: _____

-
- Aplikacioni për lidhje: Nr. _____ Datë: _____
 - Inspektimi ne vendin e ngjarjes: Datë: _____
 - Leja e autoritetit Komunal: Nr. _____ Datë: _____
 - Vendimi për Aprovimin e lidhjes: Nr. _____ Datë: _____
 - Dëftesa për pagesën e kryer: Nr. _____ Vlera (€): _____ Datë: _____
 - Lidhja e ekzekutuar: Urdhëresa e Punës Nr: _____ Datë: _____
 - Gypi i lidhjes: Materiali: _____ DN: _____
 - Ujëmatësi: Lloji: _____ Nr. _____ Kapaciteti dhe Profili: _____

Vërejtje:

Menaxheri i Departamentit te Shërbimit me Konsumatorë:
